



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 09

Datë: 06. 04. 2023. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

- Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes Nr.07/2023

2. Aktivitetet e SKQZ-së

3. Aktivitetet e Zyrës

-Njoftim për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike, të vitit 2022, dhe

- Raport për vazhdimin e regjistrimit të partive politike për vitin 2023 dhe rekomandimi.

4. Raportet e Këshillave të KQZ-së

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

-Njoftim për rekomandimet KKZ-ve në komunat Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan për Qendrat e Votimit,

-Shqyrtimi dhe zëvendësimi i Anëtarëve të KKZ-ve në Zubin Potok dhe Zveçan,

-Njoftim për periudhën tre (3) ditore të Fushatës Zgjedhore,

-Shqyrtimi dhe miratimi i fletëvotimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe fletëvotimeve dhe broshurave për zgjedhjet e parakohshme për kuvende në Komunat e Zveçanit dhe Leposaviqit 23 prill 2023,

-Shqyrtimi dhe miratimi i numrit të fletëvotimeve që shtypen për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe numrit të fletëvotimeve dhe broshurave që shtypen për zgjedhjet e parakohshme për kuvende në Komunat e Zveçanit dhe Leposaviqit 23 prill 2023,

-Rekomandim për rritjen e numrit të votuesve për vendvotime për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, si dhe Zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq 23 prill 2023,

-Certifikimi i Listës Përfundimtare të Votuesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe për zgjedhjet e parakohshme për kuvende në Komunat e Zveçanit dhe Leposaviqit 23 prill 2023

- **Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**

-Shqyrtimi dhe miratimi i Ftesës së IFES, për pjesëmarrjen e KQZ-së në Pragë, Republika Çeke

-Shqyrtimi dhe miratimi i Ftesës së OSBE për pjesëmarrjen e KQZ-së në Punëtorinë Rajonale, në Shkup, Maqedonia e Veriut

-Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në vëzhgimin e zgjedhjeve në Shqipëri

- **Njoftim nga Këshilli Mbiqkyrës për Informim Publik**

5. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Fillimisht, anëtari Ilir Gashi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani dhe Sami Hamit diskutuan çështjet që lidhen me mbajtjen e zgjedhjeve të 23 prillit në katër komunat në veri të vendit: sfidat paraprake, gjendjen dhe fokusimin e KQZ –së në këto zgjedhje: përgjegjësitë, dhe bashkëpunimi me faktorët e tjerë në organizim dhe mbajtje të këtyre zgjedhjeve etj.

Në vazhdim kryetari Kreshnik Radoniqi, pas paraqitjes së agjendës dhe heqjes nga rendi i ditës të tri pikave, ftoi anëtarët e KQZ-së ta miratojnë rendin e ditës. Me 11 vota për, u miratua rendi i ditës. Në vazhdim, u miratua edhe procesverbali nr. 7/ 2023.

2. Aktivitetet e SKQZ-së:

Burim Ahmetaj, tha se për këto zgjedhje më 27 mars ka përfunduar periudha e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, dhe se është vetëm 1 votues që ka votuar përmes postes për Mitrovicën e veriut. Votimi i tij është verifikuar dhe aprovuar... Më datën 2 prill ka përfunduar periudha e sfidimit dhe e kundërshtimit të listës përfundimtare të votuesve, dhe periudha e shërbimit të votuesve. Nuk kemi asnjë kundërshtim dhe konfirmim të listës...

Po ashtu, janë katër kërkesa për ndërrim të qendrave të votimit. Kërkesat janë bërë on-line, dhe një kërkesë përmes zyrtarit të KKZ-së.

Divizioni i trajnimit ka mbajtur programin orientues, më 3 prill dhe kanë marrë pjesë të gjitha KKZ-të e të katër komunave.

Më 7 prill, organizohet trajnimi i trajnerëve. Në këtë aspekt, kemi edhe një raportim ku ka përfunduar afati i nominimeve: në Mitrovicën e veriut janë nga subjektet VV dhe PDK, dhe nominimet janë për të gjitha vendvotimet, në Leposaviq kemi nominimet nga subjekti VV me 3 anëtarë, PDK me 4 anëtarë, LDK me 2 anëtarë, dhe partia Kosovski Serba 41 nominime. Kjo komunë ka 25 vendvotime.

Në Zubin Potok VV ka nominuar 5 anëtarë, PDK me 2 anëtarë. Dhe në Zveqan, VV me 6 anëtarë dhe PDK me 2 anëtarë.

Mbajtje të tubimeve nuk ka, ne s'kemi pranuar asnjë kërkesë...

Konfirmoj se ne kemi bërë draftimin për planin e punës për Kuvendin e Kosovës, dhe ne deri në fund të prillit duhet ta përvjellim në kuvend. Këtë punë, jemi duke e bërë në koordinim me z. Elshani dhe z. Alban Krasniqi.

Gjithashtu, z. Ahmetaj raportoi edhe mbi aktivitetet e tjera që lidhen me detyrat dhe me obligimet ligjore që dalin nga plani i punës 2023.

Iliri Gashi, pyeti lidhur me atë se ne kemi marrë vendim që KKZ-të dhe ZLKZ-të të vendosen në Qendrat e Regjistrimit Civil. Mirëpo, tani ata me gjasë ata janë vendosur në stacione policore. Tash, ne duhet ta ndërrojmë vendimin. Pse ka ndodhë kështu ?

Lidhur me këtë pikë, **Burim Ahmetaj** tha se, kjo është bërë për shkak të sigurisë, por edhe hapësirë më të lirë.

Sami Kurteshi, pyeti se si është puna për raportin vjetor ? Po presim më shpejt ta kemi, dhe jo në dy – tri ditët e fundit. Ndërsa. Cështja e strategjisë mos është zvarritur pakëz...?

Burim Ahmetaj, tha se bëhet fjalë për raportin 2022 dhe ne e kemi të draftuar, dhe në fillim të javës do tua dërgojmë... Ndërsa, strategjia nuk është zvarritur por për shkak të ngarkesave të tjera, ne së shpejti do ta kemi edhe strategjinë...

Arianit Elshani, pyeti rreth nominimeve të komisionerëve dhe tha se, duhet ta kemi një pasqyrë të plotë e nominimit të komisionerëve, të mos neglizhohet por të raportohet në KOZ...njashu, edhe me raportet e tjera, pastaj me numrin e votuesve në QV – të etj. Nuk guxojmë ta rrezikojmë procesin...

Burim Ahmetaj, tha se është një rekomandim...?

Anëtarët e KQZ, miratuan rekomandimin me 11 vota për në mënyrë që të zgjatjet kontrata për 2 zyrtarë jo permanent.

3. Aktivitetet e Zyrës

Njoftim për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike, të vitit 2022, dhe Raport për vazhdimin e regjistrimit të partive politike për vitin 2023 dhe rekomandimi.

Beznik Buzhala, tha se janë dy raporte: Sa i përket të parit, ju njoftohmë se 49 parti dhe 2 iniciativa kanë dorëzuar raportet financiare. Në kuadër të zyrës, ne kemi përgatitur dokumentin me referencat

lidhur me auditimin e raporteve financiare vjetore, dhe raportet e fushatës. Do të auditohen 216 raporte. Ne, këtë obligim, e kemi deri në qershor...

Sami Kurteshi pyeti se, për çfarë auditor bëhet fjalë ! Z. Buzhala, tha se bëhet fjalë për kompani – auditor të jashtëm. Gjithashtu, diskutoi edhe Arianit Elshani, Sami Hamiti dhe Alban Krasniqi.

Besnik Buzhala: E dyta, kemi raportin për vazhdimin e regjistrimit të partive politike për vitin 2023 dhe rekomandimi. Në bazë të rregullores, partitë duhet të dorëzojnë formularin e vazhimit të regjistrimit në zyre, jo më larg se data 31 mars.

Nga gjithsej 49 parti që janë në regjistër, 48 kanë dorëzuar formularin. Një, nuk e ka dorëzuar, prandaj ne rekomandojmë që subjekti “Progresivna Demokratska Stranka” e regjistruar në prill 2014 të c’regjistrohet. Ajo, nuk e ka dorëzuar formularin...

Anëtarët e KQZ me 11 vota për, c’regjistrohet partia politike “Progresivna Demokratsna Stranka”.

Arianit Elshani, pyeti rreth ndarjes së financave për partitë, sepse partië kanë obligime.

Besnik Buzhala tha se, partitë politike duhet të dorëzojnë raportet tremujore financiare, dhe mandej bëhet pagesa për tre muaj nga fondi i partive.

Ilir Gashi, pyeti sërish rreth kërkesës së një raporti për rastin lista “Guxo”. Ju lutem, na sillni një raport që të mos diskutojmë më tej...

4. Raportet e Këshillave të KQZ-së

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Njoftim për rekomandimet KKZ-ve në komunat Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Leposaviç dhe Zveçan për Qendrat e Votimit:

Alban Krasniqi, tha se këshilli është takuar dhe kanë dalë disa rekomandime:

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarëve të KKZ-ve në Zubin Potok dhe Zveçan: Bëhet fjalë për dy zëvendësime. Kështu, Ukshin Veseli zëvendësohet me Driton Veselin nga subjekti LDK. Kurse, në Zveçan, Fatlum Kelmendi zëvendësohet me Faik Kelmendin nga subjekti PDK.

Anëtarët e KQZ, miratuan me 10 vota për këto dy zëvendësime.

Alban Krasniqi, tha se KOZ ka bërë shqyrtimin dhe miratimin e fletëvotimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe fletëvotimeve dhe broshurave për zgjedhjet e parakohshme për kuvende në Komunitet e Zveçanit dhe Leposaviqit 23 prill 2023. Janë dokumentet, formati i fletëvotimeve, broshurave...

Anëtarët e KQZ, miratuan me 10 vota miratuan dizajnin e fletëvotimeve dhe të broshuarav.

Alban Krasniqi, tha se KOZ ka shqyrtuar edhe certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe për zgjedhjet e parakohshme për kuvende në Komunitet e Zveçanit dhe Leposaviq. Kemi të bëjmë me certifikimi të listës si të tërë për një komunë. Raporti është i bashkangjitur në fq. 5. Numri i votuesve për komuna, është:

Mitrovicë e Veriut: 18 118 votues.

Zveçan: 6698 votues.

Leposaviq: 13 318 votues.

Zubin Potok: 6661 votues.

Rekomandojmë që, lista votuese si e tërë të certifikohet...

Anëtarët e KQZ, e certifikuan listën përfundimtare të votueseve me 10 vota për.

5. Njoftim nga Këshilli Mbiqyrës për Informim Publik

Fazli Stollaj: Shkurt ju informoj se kemi mbajtur 3 mbledhje dhe se kemi miratuar 8 njoftime që ndërlidhen me afatet për zgjedhjet në këto katër komuna, pra edhe me të drejtat e votuese. Këto informacione, transmetohen në 3 kanale të RTK, pastaj në radio Kosovë dhe në portalet e ndryshme, në ueb faqe të organizatave të shoqërisë civile.

6. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Kreshnik Radoniqi: Kemi tri pika, pra një ftesë nga IFES për në Pragë, një në Shkup dhe tjetra vëzhgimi i zgjedhjeve në Shqipëri. Pjesëmarrja në punëtorinë punëtorinë rajonale, në Shkup është më urgjente.

Në Pragë, tema është “Dezinformimi dhe mediat sociale”, dhe vëzhgimi i zgjedhjeve në Shqipëri.

Në Maqedoninë e veriut, do të marrin pjesë: Kreshnik Radoniqi, Besnik Buzhala dhe Alban Krasniqi.

Në Pragë (Ceki): Alban Krasniqi, Arianit Elshani dhe Valmir Elezi.

Në Shqipëri: Mbetet në koordinim: KQZ – Sekretariati...

7. Të ndryshme !